17	an 88	F. pajisje trajtimi ajri Qin = 3000m ³ /h, 350Pa te disponueshem, Qout = 3200m ³ /h, 850Pa e pajisur , bateri ftohese 44kw, bateri ngrohese elektrike 23kw, filtra ajri F7 + F9 - in dhe G4 + F7 - out, e pajisur me llampat GERMICIDE sipas (specifikimit te pajisjes) elektrovalvola 3 rrugeshe per baterite, motoret inverter PLUG&FAN , kontrolli regullimit te prurjes se ajrit elektronik, panelin elektrik dhe elektronik, panel komandimi dixhital bordi dhe ne distance si dhe te gjithë sensoret e mundshem (shih spec teknike)	cope	1		
18	an 89	F. UPS 10kVA	cope	2		
19	an 90	F. ashensor sherbimi spitalor; hidraulik per transportin edhe te personave me aftesi te kufizuara dhe te shtreterve spitalor; me aftesi mbajtese 1600 kg; me kapacitet 21 persona; me 5 ndalesa; me permasa kabine 1400 x 2400 x 2170 mm.	cope	1		
20	an 91	F. aspirator ajrimi WC	cope	14		
21	an 92	F. boks pacienti	cope	50		
22	an 93	F. boks oksigjeni	cope	5		
23	an 94	F. panel diellor 200 liter, uje te ngrohte, R = 4kW, pasqyra 2 x 1m 2 dop blu, me aksesore per montimin e panelit	cope	7		
32	2.490/1a	F. automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 10A	cope	26		
33	2.490/1b	F. automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A	cope	41		
34	an 30	F. automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 25A	cope	139		
35	an 31	F. automat termo/el.manj. diferencial 4P380V, 25A	cope	2		
36	an 32	F. automat termo/el.manj. diferencial 4P 380V, 32A	cope	3		
37	an 33	F.automat termo/el.manj. diferencial 4P 380V, 85A	cope	2		
38	2. a-104	F. automat termo/el.manj. diferencial 4P 380V, 100A	cope	2		
39	an 34	F. automat termo/el.manj. diferencial 4P 380V, 150A	cope	6		
40	an 35	F.automat termo/el.manj. diferencial 4P 380V, 600A	cope	2		
41	2. a-127	F. Ndricules LED 2x36w,IP40	cope	87		
42	2.a-137	F. Ndricules LED 4x18w,IP40	cope	59		
43	2.a-132	F. Ndricules tavanor LED 1x40w	cope	51		
44	2.a-133	F. Ndricules tavanor LED 1x18w	cope	34		
45	2. a-129	F. Ndricules projektor me llampe SAP-T 250w	cope	4		
46	2. a-139	F. ndricues evakuimi me llampe 1x11w,IP40	cope	173		
47	2. a-120	F. Llampe sinjalizimi 220V;1.2w	cope	12		
48	3.An	F ndricues Smart VP CL1 CR M-S 250W GG FAE 44004,me llampe 250W/ 230V	cope	4		
49	an 36	F. dekoder kunder zjarrit	cope	129		
50	2. a-116	F. Sirene e brendshme audio vizive	cope	9		
26	An - 11	F. rezervuari zingato 5000 litra	cope	2		
27	An - 17	F. pompe me pulmon	cope	3		
33	2.511	F. hidrante Ø 50 mm + kaste + saracineske + zorre uji antizjarr	cope	8		
36	an 54	F. impiant automatik i kontrollit te pajisjeve dhe sistemit	cope	1		
16	an 56	F.Priza per gazra mjeksor	cope	141		
			SHUMA (18) II			
		SHUMA TOTAL II				
		SHUMA TOTALE(I+II)				

NR.	PERMBLEDHESE	VLEFTA
A	PUNIME NDERTIMI	
B	PUNIME ELEKTRIKE	
C	PUNIME INSTALIMI (HIDROSANITARE, NGROHJE, MBR. NGA ZJARRI)	
D	PUNIME MONTIM PAISJE	
<i>i</i>	Shuma e punimeve (A ÷ D)	
<i>ii</i>	Fondi rezerve 5 %	
iii	SHUMA (i+ii)	
iiii	T. V. SH. 20%	
	SHUMA I (iii+ iiii)	
E	FURNIZIM PAISJE (ME TVSH)	
	SHUMA II (E)	
	SHUMA TOTALE (SHUMA I+SHUMA II)	

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula

Shënim:Çmimet duhet të shprehen në Monedhën _Lekë (e kërkuar në dokumentat e tenderit)



Shtojca 2

[Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor në Marrëveshjen Kuadër gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit]

FTESA PËR OFERTË

(shkruani emrin e Autoritetit Kontraktor)

fton për të paraqitur oferta për kryerjen e Punëve të mëposhtme:

.....
.....
.....

(jepni një përshkrim të saktë të objektit të kontratë dhe sasive siç përkufizohet në Dokumentacionit të Tenderit (DT)).

Vendi i kryerjes së punës

(jepni një përshkrim të shkurtër)

Afati i punimeve

Oferta duhet të paraqitet

.....

[Jep adresën e saktë]

Përpara

.....

[Përcaktoni datën dhe orën]

Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

.....

Forma e komunikimit:

Me shkrim ☐

elektronike (email, fax, etj) ☐



Shtojca 3

[Letër me logon e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik kur kërkohet nga autoriteti kontraktor]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-së

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;

Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës ose ftesën për tender]. [Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4

LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial	Numri i faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial	Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial



Shtojca 5

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATE MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se:

Përbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me certifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula



Shtojca 6

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

☐ Shërbim: ☐ Mall: ☐ Punë: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____



Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË **Mbi konfliktin e interesave**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky

ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula



Shtojca 8

[Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik]

FORMULAR VLERËSIMI**(Ky formular do të shoqërohet me Akt kolaudimin dhe situacionet)**

Autoriteti kontraktor/Investitori	
Adresa/Tel.	
Emri i Titullarit/Administratorit	
VËRTETOJ SE:	
Autoriteti kontraktor/Investitori ka nënshkruar kontratën me	
Emri i operatorit NIPT/	
Bashkimit të operatorëve NIPTET/	
Nënkontraktoret NIPTET	
Adresa/t	
Objekti i kontratës:	
Data e fillimit të kontratës	Data e mbarimit të kontratës
Vlera sipas kontratës	Vlera e realizuar
% e bashkimit të O.E. dhe përshkrimi i punëve të kryera nga secili anëtar	
Nënkontraktoret.	
Vlerësimi	(shprehur me fjalë)
	E përmbushur
	E papërmbushur
Firma	
Vula e Autoritetit Kontraktor	

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE

Operatori ekonomik:_____

Deklaroj se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt:_____

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Dhe

Me qera					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë.

PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)**Emri:****Adresa:****Nr. Telefonit:****Faks:****E-mail:****Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):
 - a) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
 - b) nuk është dënua për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
 - c) nuk është dënua me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional,

Kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës 11 “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore.

Në rastin kur kandidati/ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, në vend të Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, do të paraqitet vendimi i Gjykatës për regjistrimin si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

2. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):

- a) ka plotësuar detyrimet fiskale,
- b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore , të lëshuar nga Administrata Tatimore.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Këto kritere (pikat 1,2) duhet të vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.

3. Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrat përkatës profesionale ose tregtarë të shtetit në të cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor, për këtë kandidatët duhet të dorëzojnë një kopje të Ekstraktit mbi historikun e subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se ai i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentat e sipërpërmendur nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendur.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

Shënim: (Në akt marrëveshje të përcaktohen qartë ndarja në %-je të punimeve që do të realizojnë secila nga shoqëritë, për tërësinë e kategorive të punimeve që përmban preventivi, ose për kategori punimesh të veçanta gjithnjë në raport me %-en e deklaruar).

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, (**nuk është e zbatueshme**) sipas Shtojcës 3;
- b. **Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;**
- c. **Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;**
- ç. **Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;**
- d. **Formular vlerësimi sipas Shtojcës 8;**
- dh. **Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9**
- e. **Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (duke përfshirë dhe muajin Janar 2017)**

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Sipas pikës 1 të Shtojcës 10 të DST

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Lidhur me gjendjen ekonomike e financiare, kandidatet duhet të plotësojnë kërkesat minimale.

- a. Vërtetim nga Dega e tatim taksave për xhiron vjetore të realizuar në secilin nga tre vitet e fundit (2014-2015-2016). *Vlera e kërkuar:* Vlera mesatare e xhiros së këtyre tre viteve, duhet të jetë sa vlera e fondit limit të kësaj procedure prokurimi.

2.3 Kapaciteti teknik:

Persa i perket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 56,890,000 lekë dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit të aktivitetit të OE duke u llogaritur nga data e zhvillimit të tenderit.

Ose

- punë të ngjashme, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit të aktivitetit të OE duke u llogaritur nga data e zhvillimit të tenderit, të jetë jo më e vogël se 227,575,000 lekë.

Plotësimi i njërës prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

●Për Kontrata për punë publike të realizuar me Subjekte Shtetërore, kërkohet të paraqiten:

- i. Kontratën/at e Sipërmarrjes,
- ii. Situacion përfundimtar të objektit,
- iii. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës nr.8,
- iv. Akt Kolaudimi përfundimtar
- v. Faturat tatimore për çdo situacion (ku të shprehen qartë datat, vlera, koha dhe natyra e punës së bërë)

●Për Kontrata për Punë Publike realizuar me Subjekte Private kërkohet të paraqiten:

- i. Kontraten/at e Sipërmarrjes,
- ii. Situacion përfundimtar të objektit,
- iii. Faturat tatimore për çdo situacion (ku të shprehen qartë datat, vlera, koha dhe natyra e punës së bërë)
- iv. Akt Kolaudimi përfundimtar
- v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës nr.8,

2- Për sa i përket aftësive teknike e profesionale Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

A. Licenca profesionale e shogërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme sipas modelit nga MPPTT:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

NP-1A	Punime Gërmimi
NP-2B	Ndërtime civile dhe industriale
NP-3A	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash.

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

NS-1A	Punime për prishjen e ndertimeve.
NS-2A	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
NS-3A	Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).
NS-4B	Punime rifiniture të muratave dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike, xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndertuese.

NS-12B	Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit.
NS-14A	Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

Operatorët e huaj duhet të paraqesin njehsimin e licencave profesionale që disponojnë (të lëshuara nga vendi i origjinës), pranë MTI në plotësimin e Licencave Profesionale të kërkuara për ekzekutimin e Kontratës.

B. Operatori Ekonomik duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve për dy vitet 2015, 2016 të jetë mesatarisht 49 punonjës në muaj (përfshirë stafin drejtues teknik).

Kjo të dëshmohet me vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën vitet 2015, 2016 dhe të shoqërohet me list-pagesat e plotësuara rregullisht sipas formularit të përcaktuar E-SIG 025/a.

C. “Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij teknik për të gjithë periudhën e zbatimit të objektit minimalisht :

c.1 nje inxhinier ndertimi me të paktën 5 vite eksperiencë në zbatim për objekte të ngjashme.

c.2 nje inxhinier mekanik me të paktën 5 vite eksperiencë në zbatim për objekte të ngjashme.

c.3 nje inxhinier elektrik me të paktën 3 vite eksperiencë në zbatim për objekte të ngjashme.

c.4 nje inxhinier hidroteknik me të paktën 3 vite eksperiencë në zbatim për objekte të ngjashme.

c.5 një inxhinier topograf me të paktën 3 vite eksperiencë në zbatim.

Për të vërtetuar këtë, për secilin prej tyre të paraqiten:

- Kontrata e vlefshme e punës mes palëve.
- Librezë pune
- Diplomë universitare

D. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anën e një deklaratë nga Administratori i shoqërisë, Drejtuesin teknik të punimeve dhe stafin teknik që do të angazhohen në objekt, sipas grafikut të punimeve.

E. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se **brenda numrit të kerkuar të punonjësve** për të realizuar këtë investim ka të punësuar në stafin e vet, punonjësit e kualifikuar si më poshte:

- 2 punonjës elektrikist me kualifikime teknike nga IQT, ose institucione të autorizuar
- 2 punonjës mekanike me kualifikime teknike nga IQT, ose institucione të autorizuar
- 2 punonjës saldatore me kualifikime teknike nga IQT, ose institucione të autorizuar
- 1 ekspert zjarrfikës me leje përkatëse për ushtrimin e profesionit. *(opsionale pjesëmarrja në staf)*

Për këtë të paraqesë kontratat të punës me punëdhënësin dhe dëshmitë të lëshuara nga IQT-ja ose institucionet e autorizuar **(brenda afatit të vlefshmërisë).**

Emrat e tyre do të verifikohen në listëpagesa.

Shënim: Për ekspertin zjarrfikës (nëse nuk është pjesë e stafit), kërkohet të paraqitet kontrata e punës dhe leja për ushtrimin e profesionit nga MPB.

F. Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik.

Kërkohen të jenë në dispozicion këto mjete pune:

<u>NR.</u>	<u>MJETET</u>	<u>SASIA</u>
<u>1</u>	<u>Kamion për furnizimin me materiale dhe largimin e mbeturinave nga objekti, me goma dhe kapacitet mbajtes 10 deri 15 ton dhe vetshkarkues.</u>	<u>2 cope</u>
<u>2</u>	<u>Kamioncine me goma me kapacitet mbajtes mbi 3 ton me karoceri fikse</u>	<u>2 cope</u>
<u>3</u>	<u>Elektrobetoniere për pergatitje betoni dhe llaci në objekt me kapacitet min 0.3 deri 0.5m3</u>	<u>1 cope</u>
<u>4</u>	<u>Motogjenerator me fuqi 5 KVA</u>	<u>1 cope</u>
<u>5</u>	<u>Depozita uji me kapacitet total</u>	<u>10 000 litra</u>
<u>6</u>	<u>Vinc kulle metalike me lartësi kollone 20m me krah horizontal me të madh se 15m, me karel levizes me kapacitet ngrites mbi 0.5 ton</u>	<u>1 cope</u>
<u>7</u>	<u>Skela metalike (për punime në lartësi)</u>	<u>1000m2</u>
<u>8</u>	<u>Rrjete mbulimi për skelat</u>	<u>800m2</u>
<u>9</u>	<u>Elektro saldatrice ose motosaldatrice</u>	<u>2 cope</u>
<u>10</u>	<u>Pompë suvatimi</u>	<u>1 copë</u>
<u>11</u>	<u>Vibrator betoni thellesie</u>	<u>1 copë</u>

Për të dëshmuar këtë, Formulari i shtojcës 9 të DST duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

- Për mjetet, nëse janë në pronësi duhet të paraqiten faturat e blerjes ose të zhdoganimit të tyre.
- Për mjetet, nëse janë me qera, duhet të paraqiten kontratat e qerave ku afati i marrjes me qera të mbulojë afatin e përfundimit të punimeve të objektit dhe faturat e blerjes ose të zhdoganimit të tyre.
- Për mjetet që shënohen në regjistra publike, nëse janë në pronësi, duhet paraqitur dokumenti që vërteton **regjistrimin (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, policën e sigurimit vjetor.**
- Për mjetet që shënohen në regjistra publike, nëse janë me qera, duhet paraqitur dokumenti që vërteton **regjistrimin (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, policën e sigurimit vjetor, dhe kontrata e qerasë e cila duhet të mbulojë afatin e përfundimit të punimeve të objektit.**

G. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2008 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO të kërkuar në këtë pikë).

H. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë për sistemin e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001 - 2004 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO të kërkuar në këtë pikë)

I. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për sistemin e menaxhimit shëndetësor dhe të sigurisë në punë **BS OHSAS 18001:2007(e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën ISO të kërkuar në këtë pikë).

J. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për garantimin e cilësisë së saldimit ISO 3834-2:2005 ose ISO 3834-2:2006 **(e vlefshme)**. (Në rastin e BOE kjo certifikatë duhet të plotësohet nga OE i cili ka marrë përsipër punimet e saldimit sipas ndarjes së punimeve në marrëveshjen mes tyre) .

K. Deklaratë e ofertuesit për modelin, kompaninë prodhuese, vendin e prodhimit për mallrat e pajisjet që do të vendosen në objekt sipas tabelës së mëposhtme :

N r	Emërtimi i pajisjes dhe specifikimet	Njësia	Sasia	Modeli	Prodhuesi	Vendi i Prodhimit
1	Pompë nxehtesie Ajër Ujë me fuqi 7-10kw 400V 3PH+N i kompletuar me pompe, akumul, ene zgjerimi, panel komandimi bordi dhe ne distance + antivibrante					
2	pajisje trajtimi ajri Qin = 3000m³/h, 350Pa te disponueshem, Qout = 3200m³/h, 850Pa e pajisur , bateri ftohese 44kw, bateri ngrohese elektrike 23kw, filtra ajri F7 + F9 - in dhe G4 + F7 - out, e pajisur me llampat GERMICIDE sipas (specifikimit te pajisjes) elektrovalvola 3 rrugeshe per baterite, motoret inverter PLUG&FAN , kontrolli regullimit te prurjes se ajrit elektronik, panelin elektrik dhe elektronik, panel komandimi dixhital bordi dhe ne distance si dhe te gjithë sensoret e mundshem					
3	ashensor sherbimi spitalor; hidraulik per transportin edhe te personave me aftesi te kufizuara dhe te shtrereve spitalor; me aftesi mbajtese 1600 kg; me kapacitet 21 persona; me 5 ndalesa; me permasa kabine 1400 x 2400 x 2170 mm.					
4	panel diellor 200 liter, uje te ngrohete, R = 4kW, pasqyra 2 x 1m 2 dop blu, me aksesore per montimin e panelit					
5	Cisco Catalyst 3560 Gigabit Switch - 48 port per rrjetin LAN					
6	F.v. dyer të brendshme importi, 210 x 225cm, hermetike, me dy kanata (panelet) xhami, me hapje me rreshqitje te paneleve me sens te kundert, hapje dhe mbyllje te automatizuar me telescopik, me hapje te autorizuar nga personeli me karte magnetike, me bateri te pavarur nga rrjeti per hapje ne rast emergjence, me hapje manuale ne rast emergjence, me doreze , me panele xhami antivandal, te temperuar, cilësi e I-rë sipas standartit te KE, jo transparent, me trashesi 1-1.5cm, T40 , me zjarrrdurueshmeri, me zeizolim 38-45dB, me kornize inox mat antibakterial					

7	F.v. dere e brendshme importi, 100 x 225cm, hermetike, me njekanate(panel) xhami, me hapje me rreshqitje te panelit , hapje dhe mbyllje te automatizuar me telescopik,me hapje te autorizuar nga personeli me karte magnetike,me bateri te pavarur nga rrjeti per hapje ne rast emergjence,me hapje manuale ne rast emergjence, me doreze , me panel xhami antivandal,te temperuar, cilësi e I-rë sipas standartit te KE,jo transparent,me trashesi 1-1.5cm,T40 , me zjarrdurueshmeri, 38-45dB, me kornize inox mat antibakterial					
---	---	--	--	--	--	--

L. Për pajisjet e tabelës së dhënë në pikën K, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje në këtë procedurë prokurimi. Për rastin kur autorizimi është lëshuar nga distributori i autorizuar, ai duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin e autorizuar.

M. Të paraqiten katalogët për të gjitha pajisjet sipas pikës K. Katalogët duhet të paraqiten në formë elektronike në www.app.gov.al. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të verdhë pajisja që ofrohet dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për këto pajisje. Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes, duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuar.

O. Operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në procedurën e prokurimit, duhet të paraqesin një vetëdeklarim që janë njohur me objektin ku do të kryhen ndërhyrjet, si dhe me projektin dhe specifikimet.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI GJENDJEN GJYQËSORE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se:

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit _____

Public Health Sector

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, Planimetritë e Objektit etj: Sipas dokumenteve bashkëlidhur DST

Specifikimet Teknike të Materialeve: Sipas dokumenteve bashkëlidhur DST

Grafiku i Punimeve: Sipas dokumenteve bashkëlidhur DST



Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Sipas dokumenteve bashkëlidhur DST

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Bashkelidhur DST



Shtojca 14.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]


[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:



Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

¹ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumenta Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguri i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____



[Drejtuesi i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara: _____

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Dokumenta Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Public Health Sector

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Drejtuesi i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhanja.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndertimit.

- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtonte ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të

mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

